

Prishtinë, 21.02.2017

SQARIMET NË PYETJET E OFERTUESËVE POTENCIAL

Me referencë në **FTESËN PËR OFERTA - SHËRBIME TË PROMOVIMIT PËR KCSF-NË (REF.NO.: 01/KCSF/2017)** dhe afatit të paracaktuar për kërkesë për sqarime, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) publikon sqarimet e mëposhtme sipas pyetjeve të ofertuesve potencial:

Pyetje 1: *Ju lutem na tregoni se a do bëhet vlerësimi final në bazë të çmimit më të ulët, apo keni menduar ndonjë "weighted average" skeme.*

Përgjigje 1: **Kriteret e vlerësimit për ofertat e pranuar për shërbime të promovimit për KCSF-në do të përbëhen nga një mesatare e peshuar të elementeve të mëposhtme:**

- **Portofolio me punët paraprake – mesatare e peshuar – 60%**
 - Numri i portofoliove të derguara që kualifikohen për shërbimet e kërkuara (20%)
 - Numri i portofoliove të kualifikuara për punën paraprake me OJQ (20%)
 - CV të stafit/personelit të kompanisë ofertuesit përgjegjës për këtë kontratë (20%)
- **Oferta financiare – mesatare e peshuar – 40%**

Pyetje 2: *Kërkojmë Dosjen e Tenderit me Titull: "Shërbime të promovimit për KCSF-në " dhe me numër prokurimi "01/KCSF/2017 "*

Përgjigje 2: **Dosja për tenderin e lartpërmendur konsiston në dokumentet e publikuara në linkun përkatës në shpalljen tek uebfaqja www.kcsfoundation.org. Ofertat duhet të dorëzohen në format të ofertuesit duke i përmbushur kriteret dhe shërbimet e kërkuara.**

Pyetje 3: *Storiet e suksesit - Si dhe ku do të shfaqen? A duhet të dizajnohen për tu publikuar në ndonjë raport apo shkruhen në web dhe shpërndahen në rrjete sociale?*

Përgjigje 3: **Storiet e suksesit do të shfaqen në formë të artikujve në uebfaqen e KCSF-së dhe të shpërndahen në rrjete sociale. Varësisht nga tema mund të publikohen edhe si artikuj ne shtyp. Të gjitha storiet e suksesit në formë tekstuale do të përdoren edhe për qëllime të raportimit.**

Pyetje 4: *Tek pjesa e rifreskimit të brendit - dizajnimi i produkteve të hulumtimit (5 forma), a duhet të ketë edhe faqosje dhe përgaditje për print apo vetëm dizajnim i ballinës dhe dy-tre faqeve të brendshme?*

Përgjigje 4: **Dizajnimi i produkteve të hulumtimit duhet të konsistoj në dizajnimin e ballinës dhe faqosjes. Për të gjitha produktet e hulumtimit që i tejkalojnë 4 faqe, përveç ballinës (front cover & back cover), faqet e brendshme mund të jenë maksimalisht në 2-3 tipe (p.sh. faqja 2, mostër e faqeve të brendshme, faqja e parafundit). Në publikimet me shumë faqe, nuk ka nevojë për dizajn të secilës faqe individuale**

(replikohet e njëjta nga mostra). Çdo produkt i dizajnuar duhet të ofroj mundësinë e ndryshimit (editimit) nga përdoruesit ditor të kompjuterit. Përgatitja e produkteve të hulumtimit për shtyp do të jetë përgjegjesi e shtypshkronjës së kontraktuar nga KCSF, që nuk është pjesë përbërëse e kësaj ftese/procesi të prokurimit.

Pyetje 5: *Çfarë lloje të produkteve të hulumtimit janë? A janë raporte me shumë faqe, apo sa faqe mund të përmbajnë?*

Përgjigje 5: **Produktet e hulumtimit përbëhen nga reagimet publike, komentaret, analiza të shkurta, dokumentet për politika dhe studime. Të gjitha dokumentet ndryshojnë në vëllim të faqeve nga 2-5 faqe deri në mbi 100 faqe.**

Pyetje 6: *Dizajnimi i dokumenteve - për çfarë lloje të dokumenteve është fjala?*

Përgjigje 6: **Dizajnimi i dokumenteve/materialeve kryesore konsiston në dizajnimin e letrave të komunikimit (letterhead), materialeve promovuese (fletore, folder, laps, etj.), ID të punonjësve dhe materialeve tjera që plotësojnë promovimin e brendit të rifreskuar të KCSF-së.**

Pyetje 7: *Tek ristrukturimi dhe dizajnimi i ëeb faqes, a keni kërkuar trajtim të plotë, pra ridizajnim dhe zhvillim të ëebfaqes?*

Përgjigje 7: **Në kuadër të shërbimeve të kërkuara, KCSF synon trajtimin e plotë të uebfaqës duke përfshirë ridizajnimin, zhvillimin e uebfaqës dhe specifikimit të plotë sipas pikës 2 dhe 3 të termave të referencës.**

Pyetje 8: *Pika 2 - në çfarë softëare është uebfaqja e zhvilluar?*

Përgjigje 8: **Sipas përshkrimit në pikën 2 të termave të referencës, KCSF kërkon edhe ofrimin e softuerit për menaxhim të përmbajtjes. Ofertuesit janë të lirë të propozojnë softuer që plotësojnë kërkesat dhe mundësojnë menaxhim të lehtë të përmbajtjes së uebfaqes.**

Pyetje 9: *Pika 4 - sa foto keni ne stok? A duhet të ketë fotograf në dispozicion kur ka aktivitete apo do të përdoren fotot që janë në stok?*

Përgjigje 9: **KCSF gjeneron stok vjetor të fotografive deri në 1,500 foto. Sipas pikës 4 të termave të referencës, ofertuesit duhet të prodhojnë stok me së paku 100 fotografi duke përpunuar fotografitë në stokun ekzistues, duke bërë fotografi të reja nga aktivitetet dhe/ose duke blerë fotografi. Për më shumë shihni pikën 4 të termave të referencës.**

Pyetje 10: *Pika 9 - a duhet të realizohen këto foto të suksesit apo i keni? A duhet të keni fotograf në këto ngjarje?*

Përgjigje 10: **Fotografitë për storie suksesi duhet të realizohen/sigurohen nga kompania fituese duke përcjellë aktivitetin specifik dhe/apo në raste specifike kur storie e suksesit i referohet një aktiviteti në të kaluarën fotografitë të sigurohen nga palët e treta (p.sh. përfitues të granteve apo aktiviteteve të KCSF-së) në cilësi të pranueshme.**

Pyetje 11: Pika 11 - *sa animacione do të realizohen?*

Përgjigje 11: Ofertuesit duhet të ofertojnë për realizim të një njësie të filmave të animuar. Sasia/numri i filmave të animuar do të përcaktohet nga KCSF gjatë zbatimit të kontratës.

KCSF falënderon të gjithë ofertuesit potencial që kanë treguar interesim në ftesën për oferta me numër të referencës 01/KCSF/2017 dhe njëkohësisht njofton se kërkesat e mëtutjeshme pas afatit të paracaktuar nuk do të trajtohen.

Mirëpresim ofertat tuaja!

Me respekt,
KCSF